



Prishtinë, 27.01.2023
Kodi i ZRRE-së: V_1674_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2384_11_22** i dt.24.11.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **14.12.2022**;

në seancën e mbajtur më datë **27.01.2023** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin H.G nga komuna e Lipjanit , si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2384_11_22, i datës 24.11.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 24.11.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2384_11_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit H.G dhe ka obliguar KESCO-n që të anulojë korrjigjimin plotësues nr. 149049DFE-127602 datë 19.09.2022 në vlerë **206.46€**.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi plotësues i datës 19.09.2022 për periudhën 01/2019 deri ne periudhën 06/2019 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor dhe duke u bazuar në protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 3025 datë 26.07.2022 dhe Nr.org.02Nr. 2588 datë 14.03.2022.
- Duke u bazuar nga të dhënat e njehsorit të ri nr.17664974, ku mesatarja e shpenzimeve per periudhën 01/2017 deri 06/2017 është 365 kWh/muaj, periudhën 01/2018 deri në periudhën 06/2018 është 381 kWh/muaj, periudhën 01/2019 deri në periudhën 06/2019 është 385 kWh/muaj
- Duke u bazuar nga të dhënat e njehsorit të ri elektrik nr. 20032078, ku mesatarja e shpenzimeve per periudhat 01/2020 deri në periudhën 06/2020 është 983 kWh/muaj, periudha 01/2021 deri në periudhën 06/2021 është 1,147 kWh/muaj dhe periudha 01/2022 deri në periudhën 06/2022 është 1,167 kWh/muaj



- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2384_11_22, i datës 24.11.2022 për konsumatorin Hali Gabrica.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se korrigjimi i datës 19.09.2022 është i saktë, ZRrE thekson se, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, si Ankesa e konsumatori në KESCO, Vendimi i KESCO-s, Transaksionet e konsumatorit, Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0797804 datë 19.06.2019, Procesverbali i shqyrtimit të saktësisë së matjes të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 2588 datë 14.03.2022, Procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 3025 datë 26.07.2022; korrigjimin nr. 149049DFE-127602 datë 19.09.2022, Faturat e energjisë elektrike, Ankesa e konsumatorit në DMK dhe Rrjedhën e energjisë elektrike aktive, ka gjetur se, ky pretendim nuk qëndron si i tillë.

Në një vështrim kronologjik të këtij rasti, ZRrE gjen se, me datë 19.06.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 17664974 me gjendje TL=53116 kWh dhe TU=65688 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20032078 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipet e KEDS-it kane evidentuar se ndërrimi i njehsorit behet me kërkesë te Qendrës se thirrjeve dhe se njehsori i vjetër është i djegur dhe i njëjti duhet të dërgohet ne qendrën e kalibrimit. KEDS po ashtu ka ofruar fotografi me te cilat vërtetohet se njehsori elektrik përfshi edhe pjesën e siguresave ne dalje te njehsorit.

Me datë 14.03.2022 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 17664974 me gjendje te shpenzimeve TL=53116 kWh dhe TU=65690 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është ne rregull, njehsori elektrik është i djegur, njehsori elektrik është i dëmtuar nga ana e jashtme, njehsori elektrik nuk ka probleme me sisteme matëse, njehsori elektrik bllobat(vulat) i ka në rregull, njehsori elektrik te dërgohet ne verifikim, si dhe gabimi ne matje ne T2 është -1.15%. Po ashtu ne procesverbal është evidentuar vërejtja se: njehsori elektrik në 5%, 10% dhe 20% te rrymës nominale është jashtë kufijve te lejuar te matjes te energjisë elektrike:(5% In=-21.10%), (10% In=-20.87%), (20% In=-10.98%) ndërsa ne T1 nuk e regjistron fare energjinë e shpenzuar. Me datë 26.07.2022 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 17664974 me gjendje te shpenzimeve TL=53116 kWh dhe TU=65690 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat(vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori kapakun dhe shtëpizën nga ana e epërme e ka te djegur. Ne brendi te njehsorit komisioni ka vërejtur se si pasoje e djegies se jashtme ka djegie edhe ne brendi mirëpo nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.

Bordi, pas analizimit të rrjedhës së energjisë elektrike gjeti se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore dhe se ne asnjë rast lexuesi nuk ka evidentuar qe njehsori elektrik është i dëmtuar ne çfarëdo forme përveç se në tri periudha ka evidentuar “vjedhje” përfshi edhe periudhën qershor 2019 (datë: 19.06.2019) e qe ne te njëjtën ditë është bere edhe ndërrimi i njehsorit



elektrik. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese si dhe me të hershme me njehsorin e vjetër elektrik nr. 17664974 dhe njehsorin e ri elektrik nr. 20032078 për periudha të njëjta kohore, DMK konstaton se ka ndryshim të shpenzimeve, ka rritje të shpenzimit pas ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 17664974. Po ashtu bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike vërehet se shpenzimet e konsumatorit nga periudha 09/2010 deri me rastin e ndërrimit të njehsorit nuk ka shpenzime të regjistruara në tarifën e ulet përveç disa periudhave kur është faturuar me shpenzime por që të njëjtat janë korigjuar dhe kthyer në gjendjen e më parshme. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 17664974 për periudhën 01/2017 deri në periudhën 06/2017 është 365 kWh/muaj, periudhën 01/2018 deri në periudhën 06/2018 është 381 kWh/muaj, periudhën 01/2019 deri në periudhën 06/2019 është 385 kWh/muaj kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 20032078 periudha 01/2020 deri në periudhën 06/2020 është 983 kWh/muaj, periudha 01/2021 deri në periudhën 06/2021 është 1,147 kWh/muaj dhe periudha 01/2022 deri në periudhën 06/2022 është 1,167 kWh/muaj.

Me datë 19.09.2022 Departamenti i faturimit në KESCO bazuar në procesverbalin e shqyrtimit të saktësisë së matjes të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 2588 datë 14.03.2022 si dhe procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 3025 datë 26.07.2022 të njehsorit elektrik nr. 17664974 përmes korigjimit nr. 149049DFE-127602 ka bërë korigjimin plotësues në vlerë **206.46€** për faturat e periudhës 01/2019 deri në periudhën 06/2019 duke ri faturuar faturat e kësaj periudhe me shpenzimin e periudhës së njëjtë 01/2020 deri në periudhën 06/2020 me njehsorin e ri nr. 20032078 si dhe ka zbritur kWh e faturuar për periudhën 01/2019 deri me 06/2019 me njehsorin kontestues nr. 17664974. Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar korigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi (Kodin e Matjes së OSSH) sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët komercial përfshin periudhën një vjeçare kurse konsumatorët familjar/shtëpiak periudhën gjashtë mujore por që në rastin e konsumatorit kemi të bëjmë me djegie të njehsorit për të cilin para periudhës 06/2019 lexuesi nuk ka evidentuar se ka dëmtime fizike si dhe faktin se rasti është njoftuar nga ana e konsumatorit i njëjti nuk duhet të ngarkohet me korigjim shtesë.

Bordi i ZRRE po ashtu ka analizuar kërkesën e DMK dërguar KESCO, lidhur me njoftimin e pranuar nga Qendra e thirrjeve si dhe kërkesa e dërguar për ndërrim njehsori me të cilën vërtetohet se informata për djegie njehsori është përcjellë nga KEDS me datë 19.06.2019 si dhe KEDS ka ofruar dy fotografi që vërtetojnë djegien e njehsorit elektrik nr. 17664974.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në kundërshtim nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit H.G dhe
- Arkivit të ZRRE-së.